



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.105/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët : Bujar Muzaqi - kryesues, Violeta Husaj Rugova, dhe Hajriz Hoti - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Za Slobodu Pravdu i Opstanak, të parashtruar kundër subjektit politik Srpska Lista, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2025, që do të mbahen më datë 12.10.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 08.10.2025, merr këtë :

V E N D I M

I. PRANOHET e bazuar ankesa e subjektit politik Za Slobodu Pravdu i Opstanak, ZL.Anr.105/2025 datë 05.10.2025.

II. Subjektit politik Srpska Lista, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, Zgjedhjet Lokale 2025 që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025, i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 2,000.00 (dy mijë) €.

III. Detyrohet Subjekti politik Srpska Lista, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II- të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datën 05.10.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesën e identifikuar me numër ZL.Anr.105/2025, nga subjekti politik Za Slobodu Pravdu i Opstanak, me te cilën pretendon se aktivistet e Za Slobodu Pravdu i Opstanak (SPO), vunë re se në rrjetin social instagram ishte publikuar një tubim parazgjedhor i subjektit politik Srpska Lista, në Soçanicë, me përmbajtje promovuese të aktivitetit parazgjedhor, ku janë përdorur disa të mitur që mbajnë material reklamues zgjedhor, e që përkrahësit e subjektit politik Srpska Lista qëndrojnë mbrapa tyre. Tutje, theksojnë se kjo përben shkelje të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024, neni 5 paragrafi 3, ku është i ndaluar angazhimi i personave nën 15 vjeç në aktivitete parazgjedhore të subjekteve politike.

Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur video incizim.

PZAP i ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë, subjektit politik Srpska Lista, të njëjtën e ka pranuar, mirëpo nuk kanë kthyer përgjigje brenda afatit kohor.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, gjeti se :

-Ankesa është e bazuar.

Paneli ka gjetur se video inxhizimi i ofruar si provë në shkresat e lëndës, nga parashtuesi i ankesës, në mënyrë të padyshimtë ka konstatuar se në tubimin e subjektit politik Srpska Lista, për fushatë zgjedhore në Soçanicë, kanë marrë pjesë edhe fëmijët, veprime këto që bien në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 5, par.3 të Rregullores Zgjedhore nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se *“Asnjë subjekt politik i certifikuar nuk mund të angazhojë persona nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç në fushatë zgjedhore. Pjesëmarrja e fëmijëve në fushatën zgjedhore, nuk mund të bëhet pa prezencën apo pëlqimin e prindërve.”*.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim : se përfshirja e fëmijëve në fushatë zgjedhore përbenë shkelje të drejtave të tyre, dhe se nuk është në interesin më të mirë të tyre pjesëmarrja në fushatë zgjedhore, po ashtu paneli ka vlerësuar natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, faktin se subjekti Srpska Lista, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës zgjedhore.

Kështu që duke u mbështetur në nenin 117.3 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të bazuara, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtuesi i ankesës paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e pranoi të bazuar.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim nenit 118 paragrafi 1, dhe nenit 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.105/2025 datë 08.10.2025

Kryesues i Panelit,
Bujar Muzaqi



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.